



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr 3748 Prot

Gjirokastër më 07 / 05 :2024

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 30.04 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 30.04 .2024.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në 30.04 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10.

Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë. Mungojnë në mbledhje , Feruni, Leskaj, Qeli, Koçollari, Rova, Kristidhi.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 29. 03.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.04. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.04. 2024”.

4.P/ Vendim“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen Z.Çlirim Gjoksi i cili është dëmtuar nga djegja e banesës së tij private si rezultat i rënies së zjarrit “

5.P/Vendim “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe kullosore”.

6.P/ Vendim “Për një shtesë në vendimin nr 113, datë 14.12.2023‘Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024 ”.

7.P/Vendim “Për krijimin e Shërbimit Vullnetar për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Gjirokastër”.

8.P/Vendim “ Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”.

9.P/Vendim “ Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit në arsimin parashkollor”.

10.P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Nikolla Llambro”.

11.Raporti i punës së Drejtorisë së Urbanistikës.

12.Të ndryshme.

Znj Isaraj paraqet edhe dy kërkesa të ardhura një nga ekzekutivi në lidhje me

1. P/V” Për autorizimin e bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për zbatimin projektit të financuar nga UNESCO” ‘Kultura dhe kreativiteti në Ballkanin Perëndimor”.
2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SH.A ku kërkohet mendimi I Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura.

Z. Brahim: Pse sillet me urgjencë ky material? Meqë s ka ardhur në kohë dhe kërkohet mendimi I këshillit, të shtyhet për në mbledhjen e ardhshme. Nuk ka kaluar as në komision.

Z. Muho ; Nuk jemi dakord për rritje dhe kush e mbron këtë paterial që na propozohet për të dhënë mendim. Specialistët përkatës duhet të ishin këtu.

ZNJ. Anila Cacaj: A janë zhvilluar seancat e këshillimit me komunitetin në lidhje me tokat me qira? Neni 18 kërkon që para se materiali të vijë në Këshill duhen seancat e këshillimit me komunitetin e zonës.

Z. Brahim: Është më mirë të jepen me qira e të punohen tokat se ligji I detyron që ta dorëzojnë tokën nëse nuk e punojnë.

Hidhet në votë të futet në rendin e ditës pika e parë shtesë.

Znj. Isaraj: Në lidhje me pikën e dyte ne e futim në rendin e ditës dhe e diskutojmë, nuk merret vendim, kërkohet të jepet mendimi yne dhe pasi të dëgjojmë edhe specialistët përkatës, pra nuk marrim vendim si këshill.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro futja në rendin e ditës të pikës 1 shtesë .

Pika 2 shtesë miratohet të futet në rendin e ditës me 11 vota pro, 7 kundër dhe 3 abstenim.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro procesverballi I mbledhjes së datës 29.03,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.04. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.04 2024”.të cilat miratohen me 21 vota pro.

ZNJ Isaraj: Paraqest pikën 4 ,material I cili nuk u fut mbledhjen e kaluar sepse erdhi me vonesë

Z. Brahim: Janë 3 familje, pse ka ardhur vetëm për një të një prej tyre?

Vjen në mbledhje z. Aliko në orën 12:25 min.

Z. Aliko: Po për familjen tjetër pse nuk është përgatitur materiali, apo se janë me aftësi të kufizuar, kush e bën mat në këtë rast, a nuk e ka detyrim bashkia ta bëjë këtë gjë?

Të mërren emergjencat civile dhe administrator I qytetit.

Z. Brahim: Pse një familje dëmshpërblehet dhe tjetra jo?Po është zjarrvënie me dashje të merret në hetim.Nëse nuk I bën dot dokumentat se është me aftësi të kufizuar të merreni ju si bashki me dokumentat.

Z. Nebiaj: Nuk ka dokumentacion që është me aftësi të kufizuar, por është I dyshuar për zjarrvënie.

Znj.Isaraj :Hedh në votë dhe miratohet me 21 vota pro P/Vendim “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen Z.Çlirim Gjoksi i cili është dëmtuar nga djegja e banesës së tij private si rezultat i rënies së zjarrit “

Diskutohet pika 5. P/ V Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe kullimore me qira.”

Z. Aliko:A ka informacion të duhur që në këto sipërfaqe nuk ka mbivendosje? A ka më shumë se një kërkesë për një sipërfaqe toke?

Z. Nebiaj: Këshilli bashkiak nuk miraton emra konkretë, miraton sipërfaqe, më tej organizohen të gjitha procedurat për dhënien e sipërfaqeve bujqësore dhe kullimore me qira.

ZNJ. Cacaj: Në lidhje me pyetjen time për seancat e këshillimit me qytetarët.

Z. Nebiaj: Bashkia Gjirokastër ka zhvilluar seanca dëgjimore, ku ka mbledhur mendimet dhe kërkesat e banorëve në njësitë administrative.

Në bazë të udhëzimit nr1 të Ministrisë së mjedisit, pronat dhe kullotat me çertifikatë pronësie dhe hapen procedurat e ankandit .Pronat janë të regjistruara pranë ASHK, janë pronësi e Bashkisë Gjirokastër.Pasi mbaron miratimi në Këshillin Bashkiak mund të konkurojnë për marrjen e tyre me qira.

Znj.Cacaj: Cilët banorë kanë marrë pjesë në këto takime? Vetëm një herë në vit bëhen këto? Për të gjitha çështjet mbledhen njëherë në vit kërkesat? Kush ka marrë pjesë në këto dëgjesa?

Z. Brahim: Në këto dëgjesa e kemi të gjithë detyrimin , unë kam marrë pjesë në disa prej tyre.

Znj.Isaraj hedh në votë pikën 5 P/Vendim “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe kullimore”.

Miratohet kjo pikë me 18 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim.

ZNJ Isaraj: trajtojmë pikën 6.

Shpjegon për pikën 6 znj Florida Çelo.Këto ndryshime mbështesin nevojën për punonjës sezonalë për DMZSH në Bashkinë Gjirokastër.

Saktësim në zërin dezinfektim në mjediset e IA, nevoja për personel ndihmës në IA, Nevoja për instructor në QKF dhe dy zëra për Drejtorinë e Bujqaisë dhe Pylltarisë që ka të bëjë me ndërtim lerash dhe hartimin e një “ Plani menaxhimi Kullota “ me vlerë 5.990 000 lekë.

Z. Brahim: Çfarë parashikohet në Planin e Menaxhimit kulloror?

Znj ; Muho: Sqaron se është detyrim ligjor hartimi I këtij plani dhe nëse ky plan mungon pasojat janë edhe gjobë ndaj institucionit të bashkisë. Kemi parashikuar në këtë NJ. A sepse ka nr më të lartë të krerëve Ky plan rikoncepton masat që duhen marrë dhe investimet që duhen kryer në bazë edhe të nevojave.Për hartimin e planit ka ekspert , i cili zgjidhet me çmim reference.

Z. Brahim: Pse është kjo shifër?

Znj. Muho: Është çmim reference në bazë të sipërfaqes së tokës.

Z. Aliko: Ky është studim apo investim?

Nëse kemi studim a ka një project? Aka preventive, a ka plan investimi? Sa ha tokë do të përfshihet? Duhet të dimë sa krerë janë, sa është ky investim?Kemi lera në këtë territory, a janë funksionale?

ZNJ. Muho: Është kaluar edhe në mbledhjen në mars. Përzgjedhja është bërë në bazë të nr të krerëve.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro, një kundër dhe tre abstenime P/Vendim “Për një shtesë në vendimin nr 113, datë 14.12.2023‘Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024 ”.

Kalohet te pika 7 e rendit të ditës P/V “Për krijimin e Shërbimit Vullnetar për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Gjirokastër”.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro .

Pika 8 e rendit të ditës hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro.P/Vendim “ Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”

Kalohet te pika 9 e rendit të ditës: .P/Vendim “ Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit në arsimin parashkollor”.

Z. Aliko: Kopshtet në fshatra pse varen nga drejtuesit e shkollave, a është kjo e mbështetur në ligj?

Z. Ylli Muho: Ky plan sjell edhe këtë ndryshim, është I planifikuar për periudhën 2024 -2026 . Do të vendoset një drejtuese kopshti për të gjitha Njësitë Administrative.

z. Aliko: Më vjen mirë që po iktheni sytë nga Arsimi Parashkollor, kushtet e fëmijëve janë mizerabël, të ketë më shumë buxhet dhe të krijohet një buxhet mbështetës .

ZNJ.LIONGO” Bashkia e ka pasur prioritetet shërbimin arsimor, ky plan e çon më tej dhe na jep edhe mundësi për mbështetje nga donatorët.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro pika P/Vendim “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit në arsimin parashkollor”.

Znj. Isaraj: Kalojmë te pika e parë shtesë: 1.P/V” Për autorizimin e bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për zbatimin projektit të financuar nga UNESCO” ‘Kultura dhe kreativiteti në Ballkanin Perëndimor”.

ZNJ. Muho: Bashkia Gjirokastër është e vetmja bashki fituese në 61 bashki për këtë project në bashkëpunim me UNESCO me një fond 78 mijë euro.Qëllimi është që të mbështetemi te tradita dhe ta ruajmë atë. Të mbështesim bizneset që prodhojnë produkte artizanale dhe të ndikojmë sadopak që të ofrohet për turistët produkti I Gjirokastrës.

Z. Nurçe: I bëj thirrje këshillit që të hartojë një paketë ligjore që të mbrohet trashëgimia, kultura , tradita. Këtu shitet çdo gjë, vetëm produkti artizanal nuk shitet.

Z. Novi: Ato janë rregulla që I imponon tregu, nuk mund të pengosh tregun.

Z.,Nurçe:Ka kosto të lartë produkti vendas.

ZNJ. Muho: Qëllimi është që ne të mbështesim traditën dhe të synojmë një turizëm elitare.

Prandaj vjen dhe kjo nismë e bashkisë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro P/V” Për autorizimin e bashkisë Gjirokastër për nisjen e procedurave për zbatimin projektit të financuar nga UNESCO ‘Kultura dhe kreativiteti në Ballkanin Perëndimor”.

ZNJ. Blerina Duka paraqet në PP materialin e raportit të Drejtorisë së Urbanistikës duke shpjeguar me shifra konkrete shërbimet që ofrohen për qytetarët, projektet dhe punet e kryera , si dhe punët në vazhdim të kësaj drejtorie.

ZNJ: Isaraj: Falënderojmë znj. Duka për prezantimin e detajuar dhe specific.

Pyetje rreth raportit: Z. Aliko:A nxirni leje ndërtimi për objektet që ndërtoni vetë si bashki dhe a janë hipotekuar të gjitha pronat e bashkisë Gjirokastër?

Znj. Duka: Patjetër që po nxjerrim lejen e ndërtimit.

ZNJ. Muho: Në buxhetin e 2024 është parashikuar një fond për këtë gjë, për hipotekimin e pronave, sepse nuk fillon asnjë investim pa u hipotekuar.

Z.Brahimi: A është marrë në dorëzim Ujësjiellësi i Lazaratit?

Pasarelën kur do ta bëni , se shkolla ka filluar.

ZNJ. Cacaj: Te lejet e ndërtimit ju thatë që janë dhenë 147 leje dhe 66 janë refuzuar. Si veprohet me refuzimet më tej?

ZNJ. Duka: Këto janë të dhënat e dala nga sistemi. Në rastet e refuzimit plotësohet dokumentacioni nese mungon dhe vazhdohet përsëri me procedurën.

Z. Aliko. Në ish komunën Picar është një konflikt për rrugën me familjen Seferi. Ndiqeni me instanca, sepse kanali 2-6 m I bënte punë. Të ndiqet dhe të sqarohen që të mos ketë probleme, të sqarohen që është tokë bashkie.

ZNJ. Isaraj; Kalojmë te pika e dytë shtesë; Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SH.A ku kërkohet mendimi I Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura.

Z. Muho: Nuk jemi dakord për këtë ndryshim të tarifave.

ZNJ. Çelestina Dajlani” Përfaqësuese e UK Gjirokastër , Sqaron se nuk kërkohet vendim nga Këshilli Bashkiak . Autoriteti për të bërë ndryshimet është ERE dhe duhet një aplikim deri në 30 qershor. Në do të zhvillojmë edhe një seancë dëgjimore me komunitetin.

Këshilltarët drejtuan pyetjet: Pse duhet rritur çmimi?

A është bërë dëgjuesë publike për këtë?

Pse keni ardhur në Këshillin Bashkiak?


Z. Brahimi: Nuk jemi dakord për asnjë ngritje të tarifave.

Zx. Aliko: Në bazë të ligjit 139, ka tjetër profil në trajtimin e ujësjetllës, para se të vinit këtu duhet të realizoni dëgjuesë publike.

Asnjë nga këshilltarët nuk u shpreh pozitivisht për rritjen e tarifave dhe për materialin e ardhur në Këshillin Bashkiak.

Mbyllet mbledhja në orën 13:45 min.

**Sekretar i Këshillit**  
**Etleva Yzo**



**Kryetar i Këshillit**  
**Merita Isaraj**

